

Njoftim

Sot, më datë **24.04.2023**, ora **15:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Blerona Hasa (Relatore);**
- 2. Marsela Dervishi (Anëtare);**
- 3. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 4. Emona Muçi (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. “Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.13 Regj.Themeltar, Datë 18.04.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Indrit Sefa.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ.

Person i interesuar: Partia Socialiste e Shqipërisë.

Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 53, datë 10.04.2023 të KAS për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 48, datë 07.04.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”. Shfuqizimi pjesërisht i vendimit nr. 300, datë 05.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “*Verifikimi i deklarimeve në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023*”. Ndalimin e kandidimit të Kandidatit për Kryetar Bashkie të Mallakastrës shtetasit Qerim Ismail Ismailaj të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

OSE

Detyrimin e KAS të marrë vendim dhe të shprehet në lidhje me ankimin e paraqitur nga ana e Partia Demokratike e Shqipërisë për vendimin nr. 300, datë 05.04.2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “n”, e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 2 dhe 4 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të Kreut V, pikat 5 dhe 12 të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara

mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Kërkesën datë 24.04.2023, ora 14:52, dorëzuar nga pala paditëse në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit, me objekt “Pushimi i gjykimit”, me Vendimin Nr. 15, datë 24.04.2023, unanimisht,

VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
4. U shpall në Tiranë më datë 24.04.2023.

Tiranë, më 24.04.2023.

Gjykata Administrative e Apelit